

## *Dokumentacioni i nevojshëm për pajisjen me leje zhvillimi nga autoriteti vendor*

- Referuar **Ligjit 107/2014 datë 01.10.2014** “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, Neni 29, përcakton se, *Kryetari i bashkisë është përgjegjës për vendimmarrjen lidhur me aplikimet për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi në territorin administrativ të bashkisë.*
- Në **VKM Nr. 408, Datë 13.5.2015**, “Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar me **VKM nr. 271, datë 06.04.2016**, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 408, datë 13.05.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, të ndryshuar”, **VKM nr. 231, datë 21.03.2017**, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 408, datë 13.05.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, të ndryshuar” dhe **VKM Nr. 355, datë 19.04.2017**, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 408, datë 13.05.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, të ndryshuar”, Neni 10, përcakton dokumentacionin e nevojshëm për pajisje me leje zhvillimi, për ato zhvillime për të cilat është përgjegjës autoriteti vendor.

### *Dokumentet që duhet të paraqesë pronari ose zhvilluesi për t’u pajisur me leje zhvillimi nga bashkia janë:*

- a) kërkesa për leje, sipas formatit të aplikimit, të përcaktuar në rregulloren e zhvillimit dhe në sistemin elektronik të lejeve;*
- b) prokura ose autorizimi, në emër të personit fizik apo juridik, në rast se kërkesa paraqitet nga një përfaqësues i pronarit ose zhvilluesit;*
- c) dokument që vërteton të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në zhvillim dhe, nëse ka, kopje të marrëveshjeve për pronën;*
- ç) planin e rilevimit të pronës, në shkallë 1:500, nga topograf i licencuar;*
- d) projektidenë arkitektonike të zhvillimit;*
- dh) kopje të licencës së topografit dhe projektuesit, sipas shkronjave “ç” dh “d”;*
- e) mandatpagesën e tarifës së aplikimit, nëse parashikohet.*